

Terminologji gjuhësore

Çështje të emërtimit të njësive më themelore sintaksore në gramatikat tona

Mr. Agim Spahiu

24 prill 2004

Përmbledhje

Ndonëse gjuhësia shqiptare ka bërë një traditë të gjatë të veprimtarisë së vet, në fushën e terminologjisë gjuhësore ka ende tema të cilat mund të diskutohen e të rishikohen, siç është rasti me këtë temë të cilën do ta shtjellojmë në vijim të këtij shkrimi. Fjalën e kemi për disa terma gjuhësorë të cilët me vite e decenie janë krijuar a farkuar nga studiues të ndryshëm të gjuhësisë shqiptare, porse sot kur t' i marrim e t' i vështrojmë nga një gamë më të gjerë aspektesh, na krijohet përshtypja se edhe për këtë pikë kemi se çka të themi, ngase ka mundësi të shoshiten, të diskutohen, madje, në instancë të fundit, disa të merren edhe si të diskutueshëm. I konsiderojmë si të këtyllë, për vetë faktin se te disa terma gramatikorë, të cilët emërtojmë njësitë më themelore sintaksore, sikur nuk e shprehin përmbajtjen në tërësi, për çka edhe janë sajuar. Pra, kemi një shpërpjestim të formës me përmbajtjen e tyre.

1 Hyrje

Edhe pse fusha e gramatologjisë shqiptare ka një traditë të gjatë të ekzistimit dhe të veprimtimit të saj, çështja e terminologjisë së saj, po të vështrohet sot nga një këndvështrim më i gjerë dhe në raport me gjuhët e tjera, në mjaft pika është për t' u diskutuar, rishikuar dhe, në disa raste, edhe për t' u ndryshuar.

Një prej çështjeve që është për t' u diskutuar në këtë aspekt, është edhe përdorimi i fjalëtermave sintaksorë FJALI, FJALI E PËRBËRË, FRAZË e PERIUDHË.

2 Përdorimi dhe kuptimi i tyre në gramatikat e studimet tona

Fjalja është fjalëtermi më i shpeshtë të cilin e ndeshim në sintaksën e gjuhës sonë. Përdoret për të shënuar njësinë më themelore kumtuuese-komunikative e intonacionore të ligjërit tonë. Ndërsa, njësia më e lartë se kjo është quajtur me emra të ndryshëm, si: frazë, fjali e

përbërë dhe periudhë. Këto emërtime të ndryshme, sidomos emërtimi i fundit, na duket se është paksa i diskutueshëm dhe jo shumë i përshtatshëm për të emërtuar këtë njësi gramatikore. Prandaj pikërisht kjo çështje do të jetë edhe objekt diskutimi/ shqyrtimi në këtë shkrim.

Pothuajse në të gjitha gramatikat e shqipes periudha është përkufizuar si një ndërtim sintaksor që përbëhet prej dy a më shumë fjalish kallëzuesore dhe formon një njësi kumtuese, gramatikore dhe intonacionore.

Në vitet e 50-ta të shekullit që sapo e lamë pas, **M. Domi** në gramatikat e tij ka përdorur termin frazë, ndërsa në vitet e 60-ta e 70-ta **S. Prifti**, **S. Floqi** e ndonjë tjetër kanë përdorur termin periudhë. Ky term ka vazhduar të përdoret pastaj jo vetëm në vëllimin e njohur *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe III*, por edhe në tekstin e fundit universitar *Gramatika e gjuhës shqipe II të ASHSH-së, 1995/ 1998*. Por, për dallim prej tyre, në vitet 70-80, **R. Përnaska** në gramatikën e tij ka bërë një përpjekje për të ndryshuar diçka në këtë drejtim: Ai i ka futur në përdorim emërtimet: *fjalja e përbërë*, për ta zëvendësuar termin *periudhë* dhe *pjesa e nënrenditur*, për të zëvendësuar emërtimin *fjalja e varur*.

Edhe në vitet e 90-ta përsëri shohim një përpjekje nga ana e **M. Totonit** për një rikthim të temit *frazë* në studimet e tij. Mirëpo hartuesit e teksteve të përmendura universitare sikur e kanë legjitimuar zyrtarisht termin *periudhë*. Pse ndodh kjo është shumë vështirë t' i jepet kësaj një përgjigje e saktë. Ndoshta arsyeja e vetme është se ky term tashmë në gramatikat dhe në gjuhësinë tonë, në përgjithësi, ka bërë një jetë të gjatë përdorimi.

3 Cilat ekuivalente i përdorin gjuhët e tjera për t' i shënuar këto njësi sintaksore?

Në këtë pikë studimet frënge e angleze prijnë me një qartësi më të madhe terminologjike, sesa, fjala vjen, ato të gjuhës gjermane e ndonjë tjetër. Kështu p.sh. gjuha frënge, njësinë më të madhe gjuhësore, kumtuese e intonacionore të ligjërimit të folur e të shkruar e quan **FRAZË** (La phrase), ndërsa atë si pjesë përbërëse të saj, që ka një bërthamë kallëzuesore të pranishme apo jo, e quan **PROPOZICION** (La proposition). Studiuesit e kësaj gjuhe veçojnë pastaj **FRAZËN E THJESHTË** (La phrase simple) dhe **FRAZËN E PËRBËRË** (La phrase complexe). Frazja e thjeshtë mund të jetë ekuivalente me atë që ne e quajmë fjali, qoftë njëkryegjymtyrëshe (me gjymtyrë minimale), qoftë dykryegjymtyrëshe (e zgjeruar me një a disa plotës rrethana etj.), por që e ka intonacionin e vet të përmbarimit. Ndërsa fraza e përbërë konsiderohet si bashkim i disa frazave të thjeshta; ose bashkimi i dy e më shumë propozicionesh, me funksione të njëjta (me bashkërenditje) ose klerarkike (me nënrenditje)¹.

Edhe në gjuhën angleze e kemi përafërsisht të njëjtën gjendje. Termit **frazë** të gjuhës frënge i përgjigjet termi **SENTECË** (Sentece), ndërsa atij *propozicion*, termi **KLAUZË**

¹Më gjerësisht për këtë shih: Grevis, Goosse, *Nouvelle grammaire française*, 1995, fq.72 dhe 351; M. Riegel, J.-Ch. Pellat-R. Rioul, *Grammaire méthodique du français*, Paris, 2003, f.103-108; O. Soutet, *La syntaxe du français*, Paris, 1989, f.86,87-106.

(Clause)². Por në këtë gjuhë gjejmë edhe një klasifikim tjetër: Ndërtimet që ne i quajmë *periudha me bashkërenditje*, ata i emërtojnë si **Compound Sentence**, ato me nënrenditje si **Complex Sentence**, ndërsa ato që kanë elemente të përziera si **Compound-Complex Sentence**³.

Në anën tjetër, gjermanishtja përdor emërtimet: **Satz, Der Zusammengesetzte Satz dhe Periode/Satzperiode**. Dhe secili term ka kufizimet e veta, sepse mbështetet në kritere të caktuara. P.sh. Termi **Satz** shpreh atë njësi themelore sintaksore që ne i themi **FJALI**. Ka zakonisht një bërthamë foljore/ kallëzuesore të shprehur a të nënkuptuar dhe natyrisht intonacionin e vet të mbarimit; Termi **Der Zusammengesetzte Satz** shpreh ndërtimet sintaksore që sajohen zakonisht nga dy a më shumë fjali kryesore të shkallës së njëjtë (**Satzverbindung**) ose nga një fjali kryesore a drejtuese dhe nga një a disa fjali të tjera të varura nga fjalia kryesore (**Satzgefüge**)⁴. Mirëpo termat **periudhë** dhe **Periode/Satzperiode** nuk mund të thuhet se shprehin të njëjtën gjë dhe janë analoge. Në disa pika mund të përkojnë, por në përgjithësi, në këto dy gjuhë, teorikisht kanë konceptime të ndryshme, ngase termi **periudhë** ka një shtrirje shumë më të gjerë kuptimore, meqë përmbledh në vete gjithë atë që thuhet në **Zusammengesetzte Satz** dhe në **Periode** ose **Satzperiode**. Ndërsa termi **Periode** ose **Satzperiode** konceptohet si një ndërtim shumë i gjatë sintaksor në të cilin mund të hyjnë disa dhjetëra fjali kallëzuesore të lidhura në mes vete me të gjitha llojet e mundshme të mjeteve gramatikore, që ka një unitet kuptimor dhe që e ka një intonacion të vetëm të përmbartimit. Gjatësia e tyre mund të jetë edhe nga një gjysmë faqeje e më shumë. Përdoret më tepër në fushën e retorikës, në prozë dhe në tekste shkencore⁵.

Mirëpo një pikëpërkim të plotë në mes gjermanishtes dhe shqipes mund ta shohim sa i përket emërtimit të njësisve sintaksore nga aspekti i kumtimit, ngase në gjuhën tonë përdoren emërtimet: **Fjali dëftore, fjali pyetëse, fjali dëshirore** etj., ndërsa në atë gjermane: **Aussagesatz, Fragesatz, Wunschatz**. Kjo gjë nuk është karakteristike për gjuhët frënge, angleze e ndonjë tjetër (frgj. La phrase declarative, La phrase interrogative etj., ang. Sentences declarative, interrogative etj.).

Edhe gjuha ruse ka shumë pikëpërkime me gjuhën gjermane. Në këtë gjuhë përdoren fjalëtermat **Predllazhenie** për **fjalinë, Sllazhenije predllazhenije** për **fjalinë e përbërë**, në përgjithësi (Sllazhenije podçinjonaje predllazhenije përdoret për fjalitë e përbëra me bashkërenditje, kurse Sllazhenije podçinjonaje predllazhenije për fjalitë e përbëra me nënrenditje) dhe **Period**⁶.

²Shih R.L.Trask, *The Penguin Dictionary of english grammar*, London, 2000, f.23-24/81/123/124 etj.

³Po kjo vep.e cit., f.30/31.

⁴Shih më gjerësisht: Duden 4, *Die Grammatik*, 1984, f.609-617,617-620; Helbig/ Buscha, *Deutsche Grammatik*, 1999, f.533-637,649; L.Götze, E.W.B.Hess- Lüttich, *Grammatik der Deutschen Sprache*, 1999, 387-5001 etj.

⁵Shih grammatikat e lartshënuara

⁶Shih Grup autorësh, *Russische Sprache der Gegenwart.*, Leipzig, 1989; Grup autorësh, *Russische Sprache der Gegenwart, Kommentare und Aufgaben zur Syntax*, Leipzig, 1989.

4 Përfundime

Nga këto përkufizime e përqasime terminologjike mund të nxjerrim këto përfundime:

Në literaturën tonë gramatikore gjithmonë bëhet dallimi kuptimor/teorik ndërmjet **fjalisë** dhe **fjalisë kallëzuesore**, por asnjëherë nuk bëhet dallimi terminologjik. Ky dallim kuptimor e terminologjik, siç u pa më sipër, bëhet në mënyrë të arsyeshme në gramatikat e studimet e gjuhëve frënge, angleze etj. Këto gjuhë, siç u pa më lart, përdorin termat **Phrase** dhe **Sentence** për ta shënuar atë njësi gjuhësore, kumtuese e intonacionore të cilën ne e quajmë **fjali**, në njërën anë, dhe **Proposition** e **Clause**, për ta shënuar njësinë sintaksore të cilën ne në sintaksat tona e gjejmë me emërtimin **fjali kallëzuesore**.

Kemi pasur një përpjekje nga ana **R.Përnaskës, B. Becit** e ndonjë tjetri për t'i mbuluar këto dy emërtimet e fundit me ekuivalencat *pjesa e nënrenditur...ose pjesa e bashkërenditur...në Fjalìa e përbërë me pjesë të nënrenditur....* Por, për mendimin tonë, as ky emërtim nuk është shumë i qëndrueshëm, për faktin se ajo (njësia) duhet ta ketë një emërtim me koncizë gjuhësor, siç përdorin gjuhët e përmendura. Ndërsa emërtimi **fjalìa e përbërë**, që e përdor po ky autor dhe disa të tjerë, për mendimin tonë, është më i qëlluar, më i përshtatshëm, sesa termi **periudhë**. Termi **periudhë** edhe sot e kësaj dite ka gjetur një përdorim, si të thuash, *zyrtar* në të gjitha tekstet tona shkollore të të gjitha niveleve. Por, siç u pa edhe më lart, ky fjalëterm në gramatikat e gjuhës sonë ka një kuptim shumë të gjerë, meqë i kalon edhe caqet e një njësie. Prandaj, jemi të mendimit që ky term të kufizohet vetëm në emërtimin e njësisë gjuhësore që i takon, siç është rasti i gjuhës gjermane e ruse, ose të mos përdoret fare.

Edhe termi **frazë** të cilin e ka përdorur, shumë më herët, **M. Domi** dhe **M. Totoni**, shumë më vonë, është një term që në ndërdijen tonë zgjon paksa asociacione të një termi tepër të gjerë dhe të papërkufizuar në aspektin gramatikor. Dhe për shumikë ky term mund të jetë i barabartë me *shprehje* a *thënie*. Prandaj për mendimin tonë nuk është edhe shumë i përshtatshëm të përdoret në këtë fushë.

Sido që të jetë, kjo çështje e padefinuar në shumë aspekte kërkon edhe disa koncesione që janë më të arsyeshme e më të pranueshme sot për sot për gjuhën tonë. Dhe, sipas mendimit tonë, është më mirë dhe më e arsyeshme të përligjet versioni i gjuhës angleze. Për mendimin tonë, njësia më themelore sintaksore e quajtur **FJALI** në gjuhën tonë duhet të mbetet edhe më tutje në përdorim. Kjo do t'i korrespondojë termave **SENTENCE** të gjuhës angleze dhe **PHRASE** të gjuhës frënge. Ndërsa për emërtimin periudhat me bashkërenditje të përdoret emërtimi **FJALITË E PËRBËRA** për periudhat me nënrenditje **FJALITË KOMPLEKSE**, kurse për ato ato të përziera **FJALITË E PËRBËRA-KOMPLEKSE**. Për fjalitë kallëzuesore është mirë të riaktivizohen emërtimi **NËNFJALI**, ndërsa për fjalinë kryesore a drejtuese emërtimi **KRYEFJALI**. Këta terma i ka përdorur **S. Riza** në studimet e tij në vitet e 50-60-ta. Termat **NËNFJALI** dhe **KRYEFJALI** shumë mirë u përgjigjen termave **CLAUSE** e **MAIN CLAUSE** të gjuhës angleze dhe **PROPOSITION** e **PROPOSITION PRINCIPALE** të gjuhës frënge. Termi **NËNFJALI** shumë mirë do t'i mbulojë emërtimet **FJALI E VARUR** ose **FJALI ME PJESË TË NËNRENDITUR**. Pra, në përgjithësi, ka mundësi të thuhet: *Fjalìa komplekse me nënfjali qëllimore/ kohore/ mënyrore/ vendore*

etj.? Ose : nëse nuk duam ta përdorim fjalën e huaj komplekse, atëherë ka mundësi të përdorim emërtimin: Fjalja e përbërë, të cilin e kanë përdorur **R.Përnaska, B.Beci** e ndonjë tjetër në gramatikat e tyre. Me këtë emërtim mund të përfshihen të gjitha ndërtimet me bashkërenditje (ndonëse ato kanë disa veçori të tjera) e me nënrenditje. Pra, ka mundësi të thuhet: **Fjalja e përbërë me bashkërenditje**(shtuese, veçuese, kundërshtore, përmbyllëse), ashtu siç i gjejmë në tekstet e tyre, dhe **Fjalja e përbërë me nënfjali fthilluese** [*kryefjalore, kallëzuesore, përcaktore*], *rrethanore (qëllimore, kohore, mënyrore, vendore]* etj.